



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosova**



**Komuna Hani i Elezit**  
**Opština Hani i Elezit**  
**Municipal Asamble Hani i Elezit**

---

**Në mbështetje të nenit 5 paragrafi ( i ) të Ligjit Për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/ L - 068 dhe në bazë të Ligjit mbi Vetqeverisje Lokale Nr. 03 / L-040, Drejtoria e Arsimit të Hanit të Elezit në bazë të autorizimeve të veta dhe propozimeve nga këshilli i shkollës propozon :**

**RREGULLAT**  
**PËR AKTIVITETET E LIRA, PËRKATËSISHT JASHTË**  
**MËSIMORE TË NXËNËSVE**

**QËLLIMI**  
**Neni 1**

1.1. Organizimi i aktiviteteve të lira bëhet me qëllim të zhvillimit të aftësive fizike, morale dhe intelektuale të nxënësve si dhe për plotësimin e nevojave për jetën kulturore e zbavitëse të tyre.

**OBLIGIMET E SHKOLLËS**

**Neni 2**

- 2.1. Shkolla është e obliguar që të krijoj kushte për përfshirjen masovike të nxënësve në aktivitete të lira për të cilën shprehin dëshirë dhe kanë afinitet.
- 2.2. Shkolla inkurajon nxënësit për të shpreh dëshirën se me cilin aktivitet të lirë ka vullnet që të mirët.
- 2.3. Përcaktimi i nxënësit për tu marr me aktivitete të lira përkatësisht me aktivitete jashtëmësimore bëhet sipas deklaramit të tij dhe me propozimin e arsimtarëve, të cilët i orientojnë nxënësit për aktivitete të lira (jashtëmësimore).

### **Neni 3**

- 3.1. Me qëllim të masivizimit të aktiviteteve të lira dhe të angazhimit të nxënësve si subjekt primar në veprimtarinë edukativo arsimore, shkolla formon organizatën e nxënësve, përkatësisht organizatën e rinisë së shkollës.
- 3.2. Veprimtaria e organizatës së nxënësve - rinisë shkollore mund të përcaktohet me akt të veçantë me pëlqimin paraprak të drejtorit të shkollës.
- 3.3. Organizata e nxënësve mund të nxjerr fletushkën e vet.

### **AKTIVITETET E LIRA**

#### **Neni 4**

- 4.1. Në aktivitetet e lira bëjnë pjesë:

- Garat e diturisë
- Kuizet nga lëmenjtë e ndryshme
- Kori dhe orkestra e shkollës
- Grupi dramatik
- Grupi recitues
- Grupi letrar
- Gazetarët e rinj
- Grupi i pikturës, skulpturës dizajnit
- Grupi folklorik
- Grupi i valltarëve
- Ekologët e rinj të shkollës
- Sportistët rinj: futboll, basketboll, volejball, hendboll, atletikë, karate, mundje, shah dhe aktivitete tjera.

- 4.2. Çdo grup ose seksion i aktiviteteve të lira e ka udhëheqsin e vet. Në udhëheqësi është e domosdoshme të jetë edhe një arsimtar.
- 4.3. Garat në aktivitetet e lira organizohen në nivel të klasës, shkollës, të shkollave të komunës, të Kosovës dhe në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

## **LAVDRIMI DHE SHPËRBLIMI I NXËNËSIT**

### **Neni 5**

- 5.1. Nxënësi me rezultate më të mira në aktivitete të lira lavdërohet dhe shpërblehet me mirënjohje, diploma medalje e të tjera.
- 5.2. Lloji i lëvdatave dhe të shpërblimeve e përcakton këshilli i shkollës.

## **LARGIMI I NXËNËSVE NGA AKTIVITETET E LIRA**

### **Neni 6**

- 6.1. Nxënësi nga aktivitetet e lira mund të largohet me vetëdëshirë dhe me përjashtim.
- 6.2. Përjashtimin e nxënësve e bën udhëheqësia e grupit-seksionit dhe drejtori i shkollës.
- 6.3. Përjashtimi mund të jetë i afatizuar për një, dy javë ose një muaj dhe për një vit shkollor.
- 6.4. Përjashtimi nga aktivitetet e lira bëhet për shkak të mungesave të pa arsyeshme dhe për shkak të mos disiplinës.
- 6.5. Nxënësi i përjashtuar nga aktivitetet e lira ka të drejtë ankese në Drejtorinë e Arsimit të Komunës në afatin prej 8 ditësh prej ditës së pranimit të vendimit. Ankesa paraqitet nëpërmes të drejtorisë së shkollës.

## **MJETET MATERIALE**

### **Neni 7**

- 7.1. Për organizimin e një numri të konsideruar të aktiviteteve të lira nevojiten mjete materiale.
- 7.2. Mjetet materiale mund të sigurohen nga:
  - bugjeti i shkollës
  - veprimtaria e grupit-seksionit
  - kontributet vullnetare dhe
  - donacionet.
- 7.3. Mënyra e shfrytëzimit të mjeteve materiale e kontrollon drejtori dhe këshilli i shkollës.

## **RREGULLAT**

### **Për rendin shtëpiak në Instucionet Arsimore**

#### **Neni 1**

- 1.1. Me këto rregulla përcaktohen rregullat e sjelljes, përkatësisht rregullat e rendit shtëpiak për të punësuarit dhe nxënësit e shkollës.
- 2.1. Punëtori administrativ dhe punëtori teknik i shkollës (në testin e më tejme punëtori) është i obliguar që të respektoj orarin ditor të punës të përcaktuar nga organet qeverisëse të shkollës (drejtorit ose Këshillit të shkollës).
- 2.2. Norma javore e punës është 40 orë punë efektive.
- 2.3. Në raste të jashtëzakonshme punëtori mund të angazhohet në punë edhe jashtë orarit të punës, por duke mos ndikuar negativisht në shëndetin e tij.
- 2.4. Punëtori është i obliguar që ti kryej detyrat punese në afat të caktuar kohor duke e respektuar personalitetin e nxënësit, të mësimit, të punëtorëve të shkollës dhe të interesuarve tjerë.
- 2.5. Punëtori është i obliguar të bashkëpunoj me punëtorët e tjerë të shkollës, të krijoj atmosferë pune, mirëkuptim dhe tolerancë duke mbizotëruar arsyeja e veprimit.

#### **Neni 3**

- 3.1. Mësimdhënësi është i obliguar:
  - a) të respektoj orarin ditor të mësimin,
  - b) të paraqitet në shkollë së paku 10 minuta para fillimit të orës së parë mësimore për lëndën e tij (të cilën e mban) të përcaktuar me orar të shkollës.
  - c) të respektoj orarin e ziles së shkollës, duke hyrë në klasë dhe duke dalë nga klasa sipas këtij orari (cingërimës së ziles)
  - d) të respektoj personalitetin e nxënësit, mësimit dhe të punëtorëve të tjerë të shkollës;
  - e) të bashkëpunoj me nxënësit, mësimit, prindit e nxënësve, punëtorët dhe organet qeverisëse e profesionale të shkollës;
  - f) të bashkëpunoj dhe ti ndihmoj organizatat e nxënësve të shkollës;
  - g) të kryej detyrën e kujdestarit të klasës dhe të ditës;
  - h) të mbaj dhe të ruaj me kujdes dokumentacionin shkollor, e të tjera;
  - i) Mësimdhënësi kujdestar i ditës është i obliguar të paraqitet në shkollë më së paku 20 minuta para fillimit të mësimin.

## **Neni 4**

4.1. Nxënësi është i obliguar;

- a) të vijë me rregull në shkollë me tekste dhe mjete të përcaktuara mësimore;
- b) të hyjë në klasë para fillimit të çdo ore mësimore;
- c) të jetë i sjellshëm në rrugë, në lokalet e shkollës dhe në orë mësimore;
- d) të respektojë personalitetin e mësimitdhënësit, të nxënësve të klasës dhe të nxënësve tjerë të shkollës, e të tjera.

## **Neni 5**

5.1. Nxënësit, mësimitdhënësit dhe punëtorët e shkollës janë të obliguar:

- a) të kultivojnë dhe të ruajnë ambientin shkollor;
- b) të respektojnë personalitetin e çdo individi pa marrë parasysh përkatësin nacionale fetare dhe gjinore;
- c) të mos sjellin në shkollë armë të zjarra e të ftohta si dhe mjete të ndryshme eksplozuese;
- d) të mos shkaktojnë konflikte dhe rrahje në ambientet shkollorë;
- e) të mos pinë duhan në klasë, në korridor dhe në ambiente të tjera të shkollës;
- f) të mos përdorin alkool dhe mjete tjera narkotike;
- g) të mos sjellin në shkollë persona të pa dëshiruar;
- h) të mos zhvillojnë në shkollë aktivitete politike e fetare;
- i) të ruajnë pasurinë e shkollës;
- j) të mos përdorin lokalit dhe mjetet shkollorë për punë private;
- k) të respektojnë dhe të kryejnë urdhrat e përgjegjësve të shkollës nëse ato nuk janë në kundërshtim me rregullat dhe interesat e shkollës;
- l) të mbajnë unifo5rmën, përkatësisht emblemën e shkollës;
- m) në shkollë të vihet në vend të dukshëm një kuti e mbyllur ku nxënësit, e të tjerët vejnë në kuti mendimet, propozimet dhe vërejtjet e tyre anonime;
- n) komisioni disiplinor i shkollës pas çdo muaji e hapë kutinë dhe shqyrton kërkesat anonime të nxënësve dhe të tjerëve.

## **Neni 6**

6.1. Në fillim të vitit shkollor secilit punëtor dhe nxënësve i jepet nga një kopje e këtyre rregullave.

## **RREGULLAT**

**Për sjellje dhe disiplinë të nxënësve në shkollën fillore \_\_\_\_\_ në**

\_\_\_\_\_.

### **QELLIMI**

#### **Neni 1**

- 1.1. Me këto rregulla përcaktohen të drejtat , detyrat, obligimet për sjellje dhe disiplinë të nxënësve në shkollë.
- 1.2. Marrja e masave disiplinore aplikohet nëse nxënësi nuk i rrespekton rregullat e sjelljes të përcaktuara nga shkolla.

### **TE DREJTAT E NXËNSIT**

#### **Neni 2**

2.1. Nxënësi ka të drejtë:

- a) t'i realizoj të drejtat e përcaktuara me ligjin mbi Arsimin Fillorë dhe të mesëm të Kosovës;
- b) të njoh Konventat ndërkombëtare për drejtat e fëmijëve dhe të kërkoje respektimin e tyre ;
- c) Të shpreh mendimin me gojë e me shkrim për problemet që e shqetësojnë atë,klasën e tij dhe shkollën;
- d) t'i respektohet dinjiteti moral dhe fizik;
- e) të marrë pjesë në mbledhje të nxënësve të klasës dhe të shkollës ;
- f) të zgjedh dhe të zgjidhet në këshillin e nxënësve të klasës dhe në këshillin e nxënësve të shkollës;
- g) të marrë pjesë në veprimtarit kulturore,artistike dhe sportive,të cilat i organizon klasa ose shkolla;
- h) të marrë mirënjohje dhe shpërblime për sukses të jashtëzakonshëm në mësim,në garat e diturisë,në aktivitetet kulturore dhe sportive e të tjera;
- i) të marr dokumentin përkatës për klasën e kryer dhe dokumentet tjera të nevojshme për nxënësin, të cilat i lëshon shkolla;
- j) të realizojë edhe të drejtat tjera , të cilat janë në interes e nxënësit;

## **DETYRAT DHE OBLIGIMET E NXËNSIT**

### **Neni 3**

3.1. Nxënësi ka për detyrë dhe obligim që:

- a) të respektojë rregullat për rendin shtëpiak të shkollës;
- b) të respektojë orarin mësimor dhe orarin e aktiviteteve të lira;
- c) të vij në shkollë i pajisur me tekste dhe me mjete të domosdoshme mësimore;
- d) të bart uniformën ose shenjën e përcaktuar të shkollës;
- e) të mbajë qëndrim të mire në orë mësimore, në ambientet shkollore, në rrugë dhe në shtëpi;
- f) të ketë sjellje korrekte ndaj shokëve të klasës, nxënësve të gjinisë tjetër, të përkatësisë tjetër etnike e fetare , ndaj arsimtareve dhe personelit tjetër të shkollës;
- g) të ruaj dhe të humanizoj ambientin shkollor dhe
- h) detyra e obligime të tjera, të cilat i përcaktojnë organet profesionale dhe qeverisëse të shkollës;

## **MASAT DISIPLINORE**

### **Neni 4**

4.1. Nëse nxënësi nuk i respekton rregullat e sjelljes në shkollë, atëherë kundër tij shqiptohen masat disiplinore

4.2. Masat disiplinore janë:

- a) paralajmërimi, përkatësisht qortimi;
- b) vërejtja me shkrim;
- c) përjashtimi i përkohshëm i nxënësit për të marrë pjesë në aktivitete të lira;
- d) thyerja e notës së sjelljes;
- e) ndërrimi i paraleles dhe
- f) ndërrimi i shkollës

4.3. Masën disiplinore të paralajmërimit, përkatësisht të qortimit e shqipton kujdestari i klasës.

4.4. Masat disiplinore: vërejtje me shkrim, përjashtim i përkohshëm nga aktivitetet e lira, ndërrimi i paraleles dhe thyerja e notës së sjelljes e shqipton drejtori i shkollës;

4.5. Masën disiplinore ndërrimi i shkollës e shqipton Komisionin Disiplinor;

4.6. Masa disiplinore ndërrimi i shkollës aplikohet në marrëveshje me shkollat në rreth dhe me pëlqimin e Drejtorisë së Arsimit dhe e Kulturës së Komunës.

4.7. Masa disiplinore ndërrimi i Shkollës mund të iu shqiptohet vetëm nxënësve prej klasës së VI-të deri të IX-tën.

## **Neni 5**

5.1. Paralajmërimi, përkatësisht qortimi i shqiptohet nxënësit për:

- a) moskryerjen e obligimeve të përcaktuara nga drejtuesit e shkollës;
- b) mospërdorimin e rregullt të uniformës, përkatësisht të shenjës së shkollës;
- c) ndotjen e ambientit në klase dhe në shkollë;
- d) sjellje fyese ndaj shokëve të klasës;
- e) pranimin dhe sjelljen e personave të padëshiruar në shkollë;
- f) shqetësimi që mund të iu sjell të tjerëve nëpërmjet shushurimës, zhurmës dhe të sjelljeve arrogante e të tjera.

5.2. Paralajmërimi ose qortimi, nxënit i shqiptohet në kasë dhe para këshillit të nxënësve të klasave përkatëse.

5.3. Për masën paralajmëruese njoftohet prindi i nxënësit, këshilli i klasës dhe drejtori i shkollës.

## **Neni 6**

6.1. Masa disiplinore vërejtje me shkrim i shqiptohet nxënësit për :

- a) çrregullimin e mësimit;
- b) sjellje jo korrekte ndaj shokëve të klasës , nxënësve të gjinisë tjetër , të përkatësisë tjetër etnike e fetare dhe ndaj mësimdhënësve;
- c) pirje të duhanit;
- d) bartjen e gjësendeve të rrezikshme në shkollë (brisku, thika, boksi i hekurit e të tjera);
- e) deri në 8 mungesa të paarsyeshme nga orët mësimore, e të tjera.

6.2. Vërejtja me shkrim lexohet para nxënësve të shkollës dhe një kopje i dorëzohet prindit të nxënit.

## **Neni 7**

7.1 . Përjashtimi i përkohshëm i nxënësit për të marrë pjesë në aktivitete të lira bëhet për:

- a) prishjen e disiplinës gjatë organizmit të aktiviteteve të lira;
- b) moskryerjen e detyrave të dhëna nga mësimdhënësit dhe eprorët e shkollës;
- c) cenimin e dinjitetit të shokëve të klasës dhe të nxënieve të shkollës;
- d) moszbatimin e rregullave të aktiviteteve të lira, e të tjera.



## **Neni 8**

8.1. Nota e sjelljes nxënësit e thehet për :

- 10 mungesa të paarsyeshme, nota e sjelljes zbritet në 4;
- prej 10-15 mungesa të paarsyeshme, nota e sjelljes i zbritet në 3;
- prej 15-25 mungesa të paarsyeshme, nota e sjelljes i zbritet në 2;
- mbi 25 mungesa të paarsyeshme , nota e sjelljes nxënësit i zbritet në 1.;

8.2. Nota e sjelljes, nxënësit mund t' i thehet edhe për sjellje të keçe në shkollë.

## **Neni 9**

9.1. Masa disiplinore, ndërrimi e shkollës, aplikohet për nxënësit të cilët :

- a) fyejnë arsimtarët e punëtorët tjerë të shkollës dhe i pengojnë ata në kryerjen e detyrave në shkollë e jashtë saj;
- b) pengojnë me qëllim nxënësit tjerë për të hyrë në mësim dhe për të marrë pjesë në aktivitete jashtë mësimore;
- c) falsifikojnë të dhënat në dokumente shkollore (në libra të klasës, libra amë, librezat e dëftesa);
- d) vjedhin dhe shkatërrojnë pasurin nxënësve , të mësimdhënësve dhe të shkollës;
- e) shkaktojnë rrahje në ambient të shkollës;
- f) sjellin në shkollë armë dhe lëndë plasëse e gjësente tjera vdekjeprurëse;
- g) paraqesin në provim person tjetër në vend të tij dhe anasjelltas;
- h) sjellin në shkollë dhe përdorin lëndë narkotike;

9.2. Nëse nxënësi shkatërron inventarin shkollor ,mjetet mësimore dyert e dritaret ose ndonjë gjësend tjetër të shkollës, prindi i tij është i obliguar që të paguaj dëmin në shumën që ia përcakton komisioni disiplinor ,përkatësisht komisioni profesional i shkollës.

9.3. Vendimi për ndërrimin e shkollës i dorëzohet prindit të nxënësit.

9.4. Kundër vendimit të komisionit të shkollës,prindi i nxënësit ka të drejtë ankese në Drejtorinë e Arsimit te Komunës në afatin prej 8 ditësh prej ditës së pranimit të vendimit. Ankesa paraqitet nëpërmes drejtorisë së shkollës.

## **KOMISIONI DISIPLINOR**

### **Neni 10**

- 10.1. Masën disiplinore ndërrimi i shkollës e shqipton komisioni disiplinor.
- 10.2. Komisionin disiplinor e zgjedh Këshilli i shkollës.
- 10.3. Komisioni disiplinor përbëhet prej 3 anëtarëve: dy mësimdhënësve dhe një prindi. Kryetar i Komisionit emërohet njëri prej mësimdhënësve.
- 10.4. Kërkesën për ngritjen e procedurës disiplinore kundër nxënësit e bënë drejtori i shkollës. Masa disiplinore vlen më së shumti për një vit shkollor .

## **DISPOZITA KALIMTARE**

### **Neni 11**

11.1. Nëse ndonjë dispozitë e këtyre rregullave është në kundërshtim me depozitat e Ligjit Për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës si dhe me aktet ose Udhëzimet tjera, të cilat i ka nxjerrë ose i nxjerrë MASHT, atëherë zbatohen dispozitat e Ligjit , përkatësisht të Udhëzimeve të nxjerra nga MASHT.

### **Neni 12**

- 12.1. Në fillim të vitit shkollor secilit nxënës i jepet nga një kopje e këtyre rregullave.
- 12.1. Këto rregulla hyjnë në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal Hani i Elezit.

Hani i Elezit, më \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit

\_\_\_\_\_  
Shaban Çupi